

Data ___/___/2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje paisje mobilje Shkolla Oso Dauti.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Karrige
39112000-0
Tavolina 39121200-8

VLERA E FONDIT LIMIT:

1 802 057 lekë (Pa TVSH). Nje milion e tetqind e dy mije e pesedhjetë e shtatë

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19/05/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor _Bashkia Tropojë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19/05/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Ky kriter plotësohet me përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të LPP nr. 162/2020 dhe nenin 25 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së, janë të detyrueshme për t’u plotësuar nga çdo operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Këto kriterë synojnë sigurimin e ofertimit nga operatorë ekonomikë të përgjegjshëm, të cilët janë krijuar dhe veprojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi apo legjislacionit të shtetit të origjinës.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës, përkatësisht fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar duke u bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, mbështetur në nenin 77, pika 3, e LPP, si edhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar referohet në llojin e procedurës së prokurimit, kushtëzuar nga fondi limit, i cili është nën kufirin e ulët monetar. (Neni 43, pika 2, gërma ”c” e VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar). Duke qënë se akti nënligjor njëj kufirin maksimal të vlerës së kërkuar të xhiros vjetore, autoriteti kontraktor synon që me kërkesën për këtë kriter të marrë garanci që një kandidat ose ofertues ka kapacitete të plota financiare.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat ligjore për prokurimin, neni 55 i VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar dhe Udhëzimin Nr. 7, datë 10.1.2017 ““Për disa shtesa në Udhëzimin Nr. 24, datë 2.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë””, të ndryshuar.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”, të ndryshuar, ku citohet “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020-2021-2022 dhe të shoqëruara me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar, vetëm në rastin kur

janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilanci e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të prokurimit publik (që parashikon kufirin e viteve) dhe legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar

Operatorët duhet të paraqesin akt-ekspertizën e ekspertit kontabel të autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:*

i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrijn ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;

ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrijn ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;

iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate (apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohet për më shumë se një lot).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të

plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përvoja e mëparshme, si kriter kualifikimi, garanton autoritetin se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të pikës 1 të nenit 88 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, pranohet që “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej minimalisht 3 (tre) personash. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Si dëshmi, operatorë ekonomik duhet të dorëzojnë listëpagesat nga administrata tatimore për tre muajt e fundit (shkurt 2023, mars 2023, prill 2023).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i kërkuar i punonjësve është përlllogaritur duke gjykuar si më poshtë:

Në vendosjen e numrit minimal të punonjësve është bërë një analizë bazuar te faktorët, si grafiku i lëvrimit të mallrave, transporti, montimi, zhvendosja dhe sistemimi i tyre në ambientet e AK, riparimi dhe çdo proces tjetër përgjatë periudhës së garancisë. AK nuk ka përcaktuar detyra të veçanta për punonjësit duke ia lënë organizimin e tyre kontraktorit. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë jep siguri dhe besueshmëri për autoritetin që operatori do të përmbushë kontratën brenda afatit dhe me cilësi.

Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik, e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit i parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore, shoqëruar me listpagesat është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, gjithashtu, është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 4 persona, është në përputhje me volumin e kontratës, natyrën dhe terrenin ku do të furnizohen mallrat.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë fuqinë punëtore që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fotografitë apo katalogët teknikë ose dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e artikujve me specifikimet teknike. Për standardet e kërkuara në specifikimet teknike të çdo artikulli, duhet të paraqitet si dokument kualifikues dokumentacion nga prodhuesi, ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, akredituar nga institucionet përkatëse, që dëshmon se produkti i prodhuar plotëson standartin europian të kërkuar ose për ekuivalente me to, dokument që plotëson standartin shqiptar.

a) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë garancie të mallrave që kërkohen të prokurohen, nëpërmjet së cilës duhet të marrë përsipër dhe të garantojë riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin pa pagesë, të defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit, për një periudhë 2-vjecare nga koha e marrjes në dorëzim të artikujve nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, pika 6/b dhe 6/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion furnizimet për të përmbushur kontratën, që përkojnë me kërkesat e objektit të prokurimit.

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a, 2 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) **aftësinë teknike dhe profesionale**;... 2. Për sa i përket përshatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë **se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme**

njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

Në **nenin 40** “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” **pika 5, 6 dhe 8** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:...

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 7170:2005 ose të rinovuar, për mobilje - njësia e magazinimit (ruajtjes), objekti i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit, e përkthyer në shqip, e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi:

Me anën e këtij kriteri (standartit ISO 7170:2005), mobilje - njësia e magazinimit (ruajtjes), synohet që operatori ekonomik duhet të demonstrojë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte dhe shërbime të lidhura me to që plotësojnë kërkesat e Autoritetit Kontraktor, si dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

ISO 7170:2005 përfaqëson standartin ndërkombëtar unanim të njohur si standarti që i përket kërkesave mbi metodat për përcaktimin e forcës, qëndrueshmërisë së njësive të magazinimit (si objekti i prokurimit), kur montohen dhe furnizohen para përdorimit, duke përfshirë pjesët e tyre të lëvizshme dhe jo të lëvizshme. Ky standart u vendos në bazë të nenit 79, pika 1 e tij, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, e nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kriter në përputhje me specifikimet teknike të mallit objekt prokurimi.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Për efekt të verifikimit të gjendjes gjyqësore, operatorët ekonomikë së bashku me dokumentacionin e kërkuar, duhet të sjellin edhe fotokopjen e çertifikatës personale të administratorit dhe të ortakëve të shoqërisë (nëse është rasti) të deklaruar në formularin e vetëdeklarimit. Ndërkohë, ata duhet të kenë deklaruar saktë në formular emrat e administratorit dhe të ortakëve të shoqërisë dhe numrin e identifikimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur për të verifikuar nëse personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP. Verifikimi i gjendjes gjyqësore kryhet sipas procedurës të bazuar në njoftimin e përbashkët të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 1155 prot., datë 01.02.2019 dhe Ministrisë së Drejtësisë nr. 1001/1 prot., datë 01.02.2019).

2.4.2 Operatori ekonomik i renditur në vend të parë e kështu me rradhë të tjerët, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë mostra të mallit, objekt prokurimi, (nga një njësi për çdo artikull) për vlerësimin e aspektit teknik të ofertës.

Argumentimi: Ky kriter vendoset për vlerësimin e aspektit teknik të kontratës dhe mbështetet në udhëzimin e APP nr. 03, datë 12.04.2022 “Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë”. Qëllimi i tij është për të gjykuar më mire mbi përmbushjen e specifikimeve të kërkuara për mallrat që prokurohen me qëllim që cilësia e mallit të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara prej tij.

Përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor do t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si edhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaja duhet të shoqërohen me përkthimin e certifikuar në gjuhën shqipe.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me udhrin e Kryetarit Nr 304 date 25.08.2023 sipas procesverbalit të mbajtur prej tij .

Specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës janë pjesë e dokumentave të tenderit.

NJËSIA E HARTIMIT TË DOKUMENTEVE TË TENDERIT